



Nga: Sindikata e pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO

Federata e Pavarur e Sindikatave
F.S.P.E.

Nr. 217 dt. 03.03.2023
Prishtinë

Për: **Zt. Ymer Fjezullahu**
Kryesues i Bordit

Bordi i ZRRE-së

Zt. Petrit Pepaj
Drejtore Menaxhues

Zyra e Rregullatorit për Energji

Datë: 03.03.2023

I nderuar zt. Fjezullahu,

Sindikata e pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO përmes kësaj letre shpreh shqetësimin e saj lidhur me nevojën e menjëhershme për ngritje të pagave për punonjësit e kompanisë KEDS/KESCO.

Duke qene se Zyra e Rregullatorit për Energji është institucion i pavarur dhe aprovon të hyrat për kompanitë e rregulluara në sektorin e energjisë, pra aprovon kostot për OPEX në të cilën bëjnë pjesë edhe pagat, po ju drejtohem për të shqyrtuar kërkesën tonë për ngritje të pagave në këtë proces të konsultimit publik.

Siç jemi në dijeni gjendja ekonomike gjatë këtyre viteve të fundit është bërë shumë e rëndë për qytetarët e Republikës së Kosovës. Rritja e çmimeve të shumicës nga produktet bazë duke filluar buka dhe drithërat dhe duke vazhduar me karburantet ka rënduar tej mase buxhetin e secilit qytetarë.

Sipas Agjencisë së statistikave të Kosovës norma mesatare vjetore e inflacionit për vitin 2022 ka arritur në vlerën 11.6%. Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të zbutjes së ndikimit të krizës ekonomike për shkak të rritjes së shkallës inflacionit gjatë vitit 2022 në vazhdimësi ka ofruar ndihma për sektorin publik përkatësisht për operatorët tjerë në sektorin e energjisë. Sindikata e pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO edhe viteve të kaluara ka kërkuar që pagat e punëtorëve të KEDS/KESCO të jenë në të njëjtin nivel me operatorët tjerë në sektorin e energjisë, mirëpo kjo



kërkesë nuk ka gjetur asnjëherë mbështetjen e duhur. Përderisa volumi dhe presioni i punës është rritur, pagat kanë mbetur të pandryshuara, duke ulur motivimin e punëtorëve.

Përveç kësaj Sindikata e pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO është shumë e shqetësuar edhe me ikjen e numrit të madh të punëtorëve profesional. Dy vitet e fundit KEDS/KESCO është përballur me intensitet shumë të lartë të ikjes së punëtorëve krahasuar me vitet tjera. Arsye e kësaj ikje padyshim janë kushtet më të mira të punës dhe një page më e mire për ta si në tregun e brendshëm ashtu edhe të jashtëm.

Duke marrë parasysh të lartë thënat kërkojmë nga ZRRE që para marrjes së çdo vendimi të reflektoj ngritjen e pagave. Trajtimi me paga më të djignitetshme është më se e domosdoshme në këtë kohë kur buxheti i punonjësve tanë është rënduar shumë dhe kjo po reflektohet çdo ditë e më shumë me presion të vazhdueshëm dhe pakënaqësi duke e bërë të vështirë mbarëvajtjen e operimeve ditore të kompanisë.

Marrë parasysh shqetësimet e ngritura kërkojmë nga ju që kërkesa jonë për ngritje të pagave të merret parasysh nga ZRRE në të kundërtën pakënaqësitë tona do të rezultojnë me greva dhe protesta të vazhdueshme gjatë periudhës në vazhdim.

Mbesim me shpresë që do të vlerësoni drejtë kërkesën e parashtruar.

Me respekt,

Ahmet Hyseni

Kryetar, Sindikata e pavarur Elektrokosova KEDS/KESCO

